

# PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

## NDRYSHIMI I KUSHTEVE TE LEJES SE MJEDISIT TE TIPIT A PN-6510-05-2018

Me vendndodhie: Uzina e Perpunimit te Naftes UPN,. Rruga Drize, Bashkia Fier, Qarku Fier

Zhvillues **Shoqeria: "AL GLOBAL OIL" Sh.a**

FUSHA E VEPRIMTARISE:

“Uzina e perpunimit te naftes bruto”

Aktivitetet Shtese

“Perpunimi i mbetjeve vajore hldrokarbure

ID Aktuale.

ID 1.2 Rafinerite e hidrokarbureve, naftes dhe nënprodukteve te saj dhe gazit.

ID,Shtuar

ID 5,4 b Rikuperimi i mbetjeve te rrezikshme me ane te operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10

Hartoi raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:

**“ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” Sh.p.k**

Eksperte e Mjedisit

**Ermelinda Agalliu**

---

## Permbajtja e Tabeles

1.	Qëllimi i projektit të propozuar .....	3
2.	Planimetria e vendodhjes së projektit .....	4
3.	Përshkrimi i projektit teknik.....	11
3.1.	Mënyra e trajtimit të ujrave nga ushtrimi i aktivitetit nga UPN Fier .....	11
4.	Informacion për qendrat e banuara .....	16
	Ekonomia .....	18
5.	Përshkrimi i Mjedisit Fizik .....	20
5.1.	Klima .....	20
5.2.	Temperatura .....	20
5.3.	Regjimi i reshjeve atmosferike.....	21
5.4.	Regjimi erës.....	22
5.5.	Ujërat .....	24
5.6.	Mjedisi biologjik .....	26
5.7.	Zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore.....	26
6.	Informacionin për infrastrukturën e nevojshme .....	27
7.	Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit.....	28
8.	Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;.....	29
9.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....	29
9.1.	Metodika e aplikuar për vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis.....	29
10.	PROGRAMI I MONITORIMIT.....	43
10.1.	Mekanizmi i Raportimit për Programin e Monitorimit Mjedisor.....	43

### **Figurat**

FIGURE 1 – ZONA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT NË LIDHJE ME INFRASTRUKTURËN RRUGORE .....	5
FIGURE 2 – ZONA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT (UPN), NË LIDHJE ME NJËSINË ADMINISTRATIVE .....	6
FIGURE 3 – ZONA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT (UPN), NË LIDHJE ME NJËSINË STRUKTURORE.....	6
FIGURE 4 – PLANVENDOSJA E PROJEKTIT UPN DHE IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJRAVE EKZISTUES .....	7
FIGURE 5 – PLANVENDOSJA E PROJEKTIT UPN DHE IMPIANTI I RI I TRAJTIMIT TË UJRAVE.....	8
FIGURE 6 – HARTA TOPOGRAFIKE E ZONËS SË VLERËSIMIT. (BURIMI: ASIG GEOPORTAL) .....	9
FIGURE 7 – PLANVENDOSJA E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJRAVE .....	14
FIGURE 8 – NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË FIER .....	17
FIGURE 9 – POZICIONI I ZONËS SË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT NË LIDHJE ME ZONAT E BANUARA .....	18
FIGURE 10 – ECURIA VIETORE E TEMPERATURËS MESATARE TË AJRIT (FIER).....	21
FIGURE 11 – ECURIA VIETORE E RESHJEVE DHE NUMRIT TË DITEVE ME RESHJE (FIER).....	22
FIGURE 12 – HARTA GJEOLGJIKE E ZONËS SË UPN .....	24
FIGURE 13 – ZONA E ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT NË LIDHJE ME BURIMET UJORE .....	25

## 1. Qëllimi i projektit të propozuar

Qëllimi i projektit të propozuar për ndryshimin e kushteve të leje mjedisore do të konsistoje në instalimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura hidrokarbure “api separator”, brenda sipërfaqes së uzinës, si dhe pas rishikimit të kartës teknologjike të rafinerisë së naftës, shoqëria përveçese përpunimit të naftës bruto ajo do të përpunojë edhe mbetjet vajore hidrokarbure, duke konsistuar në “Përpunimi i naftës bruto dhe mbetjeve vajore hidrokarbure.

Shoqëria “Al Global Oil” Sh.a ushtron aktivitetin në “Uzinën e përpunimit të naftës bruto” e cila ka si qëllim përpunimin e kësaj të fundit. Për zhvillimin e këtij aktiviteti shoqëria është pajisur me të gjithë dokumentacionin dhe lejet e nevojshme, si dhe është pajisur me leje mjedisi të tipit A me PN-6510-05-2018, Akt-Miratim Nr. 3464 Prot, datë 09.04.2019, nr. i identifikimit të lejeve 2788/1, K.Nr. 18.

Për shkak të linjës teknologjike dhe makinerive të amortizuara në vite të përpunimit të naftës bruto, shoqëria “Al Global Oil” Sh.a ka bërë vlerësimet e duhura për të kryer remontin e linjës teknologjike të përpunimit të naftës bruto. Ku nëpërmjet investimeve të bankës është bërë e mundur që të kryhet remonti i reparteve të amortizuara duke bërë zëvendësimet me pjesë të reja të disa prej makinerive dhe pajisjeve të linjës teknologjike të pariparueshme dhe riparimin e disa makinerive dhe pajisjeve. Këto përmirësime kanë rritur ndjeshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e rendimentit dhe efikasitetin prodhues /përpunues të fabrikës, si dhe kanë ulur ndjeshëm saisa e ujërave teknologjik dhe mbetjeve që gjenerohen. (ku deri më tani kapaciteti i instalimit arrinte në 40% të kapacitetit të plotë të saj, kjo për shkak edhe të mungesës së lëndës së parë).

Në përputhje të kushteve teknike dhe kërkesës në tregun e naftës, shoqëria “Al Global Oil” Sh.a ka bërë rishikimin e Kartës Teknologjike të Rafinerisë së Naftës. Ku tashmë përveçese përpunimit të naftës bruto ajo do të përpunojë edhe mbetjet vajore hidrokarbure, duke konsistuar në **“Përpunimi i naftës bruto dhe mbetjeve vajore hidrokarbure.**

Shoqëria “Al Global Oil” Sh.a do të përpunojë mbetjet vajore duke i futur keto të fundit për rikuperim në impiantin e rafinerisë. Mbjetet vajore hidrokarbure do të jenë : Vajra të ndotura anijesh dhe vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante.

Mbetjet vajore të gjeneruara nga industria portuale do të sillen në cisterna në ambientet e rafinerisë dhe do të shkarkohen direkt në rezervuarin e grumbullimit të naftës bruto, e cila bashkë me të do të nështrohet proceseve teknologjike nëpërmjet distilimit atmosferik, për përfitimin e nënprodukteve të naftës bruto dhe mbetjeve hidrokarbure (përfitimi i bitumit).

Mirëpo përveçese rishikimit të kartës teknologjike, një nga investimet e fundit që shoqëria “Al Global Oil” Sh.a ka ndërmarrë është edhe **Instalimi i Impiantit të Ri të Trajtimit të Ujërave të Ndotura me Hidrokarbure** brenda sipërfaqes së uzinës së përpunimit të naftës bruto. (Ku për këtë shoqëria i është nënshtruar procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe është pajisur me Vendim Për VNM-Paraprake me Nr. AN290220240011, datë 14.05.2024, Komisioni 59 për të zhvilluar projektin “Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura Hidrokarbure “API Separator”, brenda sipërfaqes së uzinës.

Kompania gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij është përballur me përipecira të shumta për shkak të në përcaktimin e lejes mjedisore trajtimi i ujrave sipërfaqësore të shirave dhe ujrave të larjës së impiantit në tërësi (këtu nuk përmendim ujrat teknologjike të dala nga procesi i përpunimit pasi këto të fundit grumbullohen në një rezervuarë të dedikuar të cilat më pas trajtohen nëpërmjet një kompanie të licensuar), trajtohen në impiantë ekzistues i cili ndodhet jashtë zonës së instalimit, ku ky I fundit në të mirëpret dhe trajton edhe ujëra të ndotura nga disa subjekte që operojnë në zonë.



Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit për një periudhë 1 vjecare, pavarësisht të gjatë monitorimeve të ujrave të shkakrimit të cilët kanë rezultuar brenda normave të përcaktuara në lejen mjedisore, ka gjykuar se impianti ekzistues i trajtimit të ujit nuk kishte rendiment apo efikasitet të lartë, kjo për shkak të disa faktorëve të ndryshme:

1. Impianti ekzistues është në funksion të disa subjekteve, dhe nuk përcakton saktë identifikimin e ndotjes;
2. Në impiantin ekzistues i cili ndodhet jashtë instalimit, trajtohen edhe ujërat të tjërë të ndotur, të cilët më pas shkarkohen në lumin Gjanica.
3. Vendosja strategjike e impiantit nuk është e përshtatshme, pasi nën ndikimin e rreshjeve me intensitet dhe daljen e lumit Gjanica nga shtrati, ujrat e patrajtura të impiantit bashkohen me ato të lumit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në gjendjen e cilësisë së tij, dhe gjithë zinxhirin që shoqëron atë.

Për këto arsye subjekti ka ndërprerë dërgimin e ujrave në impiantin e trajtimit (ekzistues) dhe ka bërë grumbullimin e tyre në depozita të veçanta, deri në instalimin e impiantit të ri brenda sipërfaqes. Në trajtimin e impiantit të ri do të bëhet i mundur identifikimi i saktë i ndikimeve. Prandaj qëllimi i këtij projekti të propozuar është ndërtimi dhe instalimi i impiantit të ri të trajtimit të ujrave të ndotura, i cili në vetëvete do të ketë qëllimin e trajtimit të ujit sipërfaqësorë të shirave dhe ujrave larës të instalimit në tërësi.

## **2. Planimetria e vendodhjes së projektit**

Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN) Fier gjendet brenda territorit të kompleksit industrial të qytetit të Fierit, i cili vendoset në pjesën jugperendimore të qytetit, rreth 1.2 km në dalje të tij. UPN pozicionohet në skajin më jugperendimor të kompleksit i cili përfshin ish Azotikun e Fierit, TEC-in e Fierit dhe Terminalin e shpërndarjes së naftës të kompanisë Bankers Petroleum Albania. I gjithë kompleksi ka akses me rrugën nacionale Fier-Vlorë nëpërmjet një degëzimi të saj në të majtë, rreth 200 m në dalje, nëpërmjet rrugës së Azotikut. Gjendja ekzistuese e gjithë infrastrukturës rrugore paraqitet e mirë.



*Figure 1 – Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me infrastrukturën rrugore*

Administrativishtë zona e zhvillimit të projektit i përketë Njësisë Administrative Portez, Bashkia Fier, Qarku Fier, dhe ndodhet e pozicionuar rreth 3 km nga qendra e qytetit të Fierit, si dhe rreth 25 km distance në vijë ajrore nga qyteti i Vlorës i cili ndodhet i pozicionuar në jug-perëndim të zonës së projektit. Uzina e përpunimit të naftës ku ushtron aktivitetin subjekti “Al Global Oil” Sh.a I përket zonës kadastrale Nr.1557, Nr.Pas 184/4.




Figure 2 – Zona e zhvillimit të projektit (UPN), në lidhje me Njësinë Administrative

Kurse përta i përketë Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe Planit të Detajuar Vendor (PDV), të Miratuar me Vendim të Keshillit Bashkiak Nr. 100, datë 06.12.2016 dhe Miratuar me Vendim të Keshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5, datë 29.12.2016 “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Fier, ajo bën pjesë në Njësinë Strukturore 8/4, e klasifikuar në kategorinë IE. Industri dhe Ekonomi 100%.




Figure 3 – Zona e zhvillimit të projektit (UPN), në lidhje me Njësinë Strukturore




Figure 4 – Planvendosja e projektit UPN dhe Impianti i Trajtimit të Ujrave Ekzistues




Figure 5 – Planvendosja e projektit UPN dhe Impianti i Ri i Trajtimit të Ujreve



Në dy planvendosjet e mësipërme gjejmë të pasqruar Uzinën e përpunimit të naftës bruto (UPN), dhe lidhjen e tyre me impiantin e trajtimit të ujrave. Në planvendosjen e pasqruar në figurën Nr.4 gjejmë impiantin e trajtimit të ujrave ekzistues (i cili është një impiant i përbashkët, ku në të shkarkojnë ujra të ndotur edhe disa subjekte të tjerë), i cili sic mund të shikohet ndodhet i pozicionuar jashtë zonës së zhvillimit të aktivitetit, dhe qartë shikohet edhe afërsia me lumin Gjanica.

Kurse në figurën Nr.5 gjendet e pasqruar planvendosja e projektit ku zhvillon aktivitetin shoqëria “Al Global Oil” Sh.a dhe impianti i ri i trajtimit të ujrave i cili ndodhet i pozicionuar në brendesi të zonës së zhvillimit të projektit(Shoqëria është pajisur me Vendim Për VNM-Paraprake për impiantin e ri). Nëpërmjetë impiantit të ri të propozuar/instaluar shoqëria do të sigurojë një trajtim më eficientë dhe me rendimet më të lartë përse i përketë trajtimit të ujrave, si dhe do të sigurojë një identifikim më të saktë të ndikimeve, të cilat mund të identifikohen lehtësisht dhe parandalojnë shkarkimet e tyre në burimet ujore pritëse.



Figure 6 – Harta topografike e zonës së vlerësimit. (Burimi: ASIG Geoportal)

### **Të dhëna teknike të shoqërise**

Zhvillues shoqëria “AL Global Oil” Sh.a i regjistruar pranë QKB, me NIPT: L62214509P, dhe adrese: Njësia Administrative Nr.5, Rruga “Sulejman Delvina”, Ndërtesa 11, Hyrja 10, Ap.7. 1019, Tiranë.

Shoqëria “Al Global Oil” Sh.a, aktualisht ushtron aktivitetin në uzinën e përpunimit të naftës bruto, dhe është pajisur me Leje Mjedisore Tipi A me PN-6510-05-2018 pajisur me Akt-Miratimi të Lejes A Nr. 3464 Prot, datë 09.04.2019, nr. i identifikimit të lejes 2788/1, K.Nr. 18.

Shoqëria në zbatim të Ligjit Nr.52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” I ndryshuar; si dhe Kreut V të Vendim Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për

transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” I ndryshuar, ka paraqitur kërkesën për ndryshim të kushteve të lejes mjedisore të tipit A me PN-6510-05-2018. Ku Agjencia Kombëtare e Mjedisit pas shqyrtimit të kërkesës ka informuar qe shoqëria “AL Global Oil” te vijoje me aplikimin per ndryshim te kushteve te lejes mjedisore.

#### **Gjendja aktuale e impiantit të ri të trajtimit të ujrave**



*Foto aktuale të impiantit të ri*

Projekti i propozuar për instalimin e impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura në vetvete përmban instalimin e pjesëve të funksionimit të tij si dhe fazën ndërtimore të objektit. Por sic mund të shikohet edhe nga fotot e pasqyruara më sipër pjesa më e madhe e punimeve ndërtimore ka përfunduar, punimet e mbetura do të konsistojnë në meremete. Kurse përveçese fazës ndërtimore, një pjesë e rëndësishme është edhe instalimi i impiantit lidhja e tij me sistemin e ujrave/tubacionet, vendosja e kapësit të hidrokarbureve, mekanizmi redaktor zinxhir, si dhe të gjitha pajisjet e tjera të nevojshme për funksionimin e impiantit të trajtimit të ujrave deri në pikën e shkarkimit të ujrave të trajtuar në pusetën fundore.

Më poshtë paraqiten të dhënat kordinative të zonës së zhvillimit të aktivitetit si dhe kordinatat e impiantit të ri të trajtimit të ujrave të ndotura:

Tabela Nr. 1 - Kordinatat e pronës

PRONA				
Sistemin Gauss-Kruger			KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4377384	4508636	461768	4507589
2	4377387	4508520	461772	4507473
3	4377394	4508519	461779	4507472
4	4377394	4508515	461779	4507468
5	4377387	4508515	461772	4507468
6	4377385	4508467	461771	4507420
7	4377358	4508467	461744	4507419
8	4377358	4508424	461744	4507376
9	4377317	4508424	461703	4507376
10	4377317	4508398	461704	4507350
11	4377256	4508398	461643	4507349
12	4377255	4508424	461641	4507375
13	4377211	4508424	461597	4507375
14	4377170	4508426	461556	4507376
15	4377169	4508674	461552	4507624
16	4377146	4508674	461529	4507624
17	4377146	4508699	461529	4507649
18	4377241	4508698	461624	4507649
19	4377241	4508636	461625	4507587

Tabela Nr. 2 - Kordinatat e impiantit të ri të trajtimit të ujrave te ndotura në brendësi të zonës së aktivitetit

IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT				
Sistemin Gauss-Kruger			KRRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4377240	4508589	461625	4507540
2	4377241	4508557	461626	4507508
3	4377233	4508557	461618	4507508
4	4377234	4508589	461618	4507540
PUSETE	4377232	4508652	461616	4507603

### 3. Përshkrimi i projektit teknik

#### 3.1. Mënyra e trajtimit të ujrave nga ushtrimi i aktivitetit nga UPN Fier

Në uzinën e përpunimit të naftës bruto gjenerohen dy rryma për ujrat e ndotur.

1. Ujërat e ndotur me hidrokarbure të cilat gjenerohen nga procesi teknologjik.

Nafta bruto e nxjerrë nga nëntoka ka një përbërje prej 80% uji dhe 20% naftë, për të cilën lind nevoja që të behet edhe ndarja e ujit nga nafta përpara se ajo të kalojë në uzinën e përpunimit, pra kjo ndarje bëhet përpara se nafta bruto të shkojë tek shoqëria "Al Global Oil". Kurse nga procesi i përpunimit/distilimi atmosferikë nga shoqëria "Al Global Oil", arrihet të përftohet naftë bruto me përmbajtje 3 % uji.

Nafta bruto me përmbajtje uji 3 % duke ju nënshtrua procesit të distilimit nën vakum arrijn që nga fraksionet e naftës që do të merren nga procesi del edhe e gjithë sasia e ujit që ndodhet në naftën bruto.

Pikerisht kjo sasi uji (fillimisht përpara përpunimit ka qënë pjesë e naftës bruto) që gjenerohet nga aktiviteti i subjektit "AL.GLOBAL OIL" sh.a grumbullohet në depozitë të vecantë dhe tërhiqet nga subjekti "TERRAOIL SËISS" sha i cili e përdor këtë sasi uji (ripërdor) sëbashku me sasinë e ujit (80% uji pjesë e naftës bruto) për ta injektuar në puse me qëllim krijimin e presionit artificial për procesin e nxjerrjes së naftës bruto.

Në këtë mënyrë shmanget shkakrimi i ujrave me përmbajtje hidrokarbure në mjedis dhe ulet ndjeshëm përdorimi i ujit të pastër në këtë proces. Këto ujra duke qënë se dalin nga procesi i cujezimit të naftës bruto, janë mëse të pershtatshme për tu injektuar sërish në puset e naftës.

Pra ujrata e ndotura me hidrokarbure të cilat gjenerohen nga procesi teknologjik, grumbullohen në një depozitë të dedikuar të cilat trajtohen nga kompania e licensuar për këtë qëllim.

Edhe në impiantin ekzistues i cili ndodhet jashtë zonës nga ana e shoqërisë nuk janë shkarkuar ujra të ndotura teknologjikë. Por sic e kemi cituar dhe prekur edhe më sipër në impiantin ekzistues të trajtimit shkarkojnë ujra të ndotur edhe disa subjekte të tjerë.

Për këtë arsye edhe identifikimi i shkarkimeve të tyre është i vështirë për tu identifikuar.

## **2. Impianti i ri i trajtimit të ujrave**

Në impiantin e ri të propozuar nga shoqëria "Al Global Oil", i cili do të ndërtohet në brendësi të zonës së zhvillimit të aktivitetit, dhe do të jetë një impiant individual i trajtimit të ujrave të dedikuar vetëm për shoqërinë "Al Global Oil", ndërtimi i këtij impianti do të sigurojë një trajtim më eficientë dhe me rendimet me të lartë përse i përketë trajtimit të ujrave, si dhe do të sigurojë një identifikim më të saktë të ndikimeve, të cilat mund të identifikohen lehtësisht dhe parandalojnë shkarkimet e tyre në burimet ujore pritëse.

Në impiantin e ri të trajtimit do të trajtohen ujrata sipërfaqesore të shirave si dhe ujrata larës të instalimit në tërësi (larja e linjës teknologjike). Këto ujra duke qënë se në shumicën e rasteve (kur behet larja e linjës teknologjike) kanë përmbajtje të lëndëve hidrokarbure, do të dërgohen për trajtim në impiantin e ri të trajtimit të ujrave të ndotur.

Në këtë impiantë nuk do të kemi përdorim të lëndëve kimike ndihmëse, pasi në këtë proces do të jëtë i thjeshtë dhe do të konsistojë në proces fizik me ndarje.

Kapaciteti i trajtimit të ujrave 15-20 m<sup>3</sup>.

### **3.1.1. Pajisjet kryesore të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura.**

1. Pompe me kapacitet 20- 30 m<sup>3</sup>/h për transportin e ujrave të ndotura nga puseta grumbulluese në qetësorin e api separator;
2. Vaska betoni të ndarë në tre pjesë, qetësori, api separator nr 1, api separator nr 2;
3. Qetësori me kapacitet 30 m<sup>3</sup>;
4. Api separator nr 1 me kapacitet 80 m<sup>3</sup>
5. Api separator nr 2 me kapacitet 80 m<sup>3</sup>
6. Pompë për transportin e hidrokarbureve të grumbulluara në vaskën grumbulluese me kapacitet 10m<sup>3</sup>/h;
7. Filter me rërë dhe cakull me kapacitet mbajtes 40 m<sup>3</sup>;
8. Enë grumbulluese beton e hidrokarbureve të kapura me kapacitet 5 m<sup>3</sup>.

### **3.1.2. Përshkrimi i funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave**

- **Pershkrimi i skemes se API separator UPN Fier, kompania "Al GLOBAL Oii" sha**

Ujrat sipërfaqësorë të cilat gjenerohen nga larjet e ndryshme të sipërfaqes së objekteve teknologjike dhe ujrat e shiut të cilat depërtojnë nëpër kanalizimet e rafinerisë nga të gjithë kanalizimet e rafinerisë do të shkojnë si fillim në një pusëtë përmbledhëse dhe me anë të një pompe do të dërgohen në seksionin e parë të api separator në qetesorin e ujrave të ndotura.

Në pjesën e sipërme do të vendoset një kapës i hidrokarbureve të cilat flotojnë mbi ujë. Hidrokarburet e kapura nga pjesa e sipërme do të dërgohen në një grumbullues të vëcantë ku do të pompohen për tu rifitur sërish në procesin teknologjik duke i përdorur si hollues.


Pas qetësorit ku ujrat lënë një pjesë të hidrokarbureve, ujrat shkojnë në api separator nr 1, ku do të bëhet e mundur përzjerja e ujrave me anë të lopatave dhe të mekanizmit redaktor zinxhir. Edhe në këtë api separator do të kemi të instaluar kapësin e hidrokarbureve të cilat flotojnë mbi ujë. Hidrokarburet e kapura nga pjesa e sipërme shkojnë në grumbulluesin e përshkruar më sipër dhe pompohen për tu rifitur sërish në procesin teknologjik duke i përdorur si hollues.

Ujrat nga api separator nr 2 do të shkojnë në zonen e filtrimit me cakull dhe rërë.

Ujrat pas janë filtruar do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës. Theksojmë se puseta fundore e shkarkimit të ujrave do të jetë brenda territorit të rafinerisë.

- **Mbetjet që do të gjenerohen nga procesi i trajtimit të ujrave**

1. Hidrokarburet do të përdoren si hollues në proceset e metejshme në rafineri.
2. Pas fazës së trajtimit të ujrave në impiat, ato do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve, në pusëtën e vendosur në brendësi të zonës së zhvillimit të aktivitetit nga subjekti.
3. Në rastë se do të kemi gjenerim të llumrave nga pastrimi i filtrit me cakull dhe rërë, do të bëhet e mundur pastrimi, grumbullimi i tyre në depozitën e ujrave teknologjike të cilat trajtohen me kontraktuesin e licensuar për këtë qëllim. Llumrat kanë përmbajtje uji dhe një pjesë të vogël emulsion dhe hidrokarbure në sasi të papërfillshme. Aktualisht subjekti ka lidhur kontratë dhe operonë me subjekti "TERRAOIL SËISS" sha i cili këto rryma i injekton në shtresat e nëntokës.



**LEGJENDA**

- 1 Pucet e ngjumbullimit te ujrave teknologjike
- 2 Pompe
- 3 Pompe
- 4 Detesuesi i ujrave teknologjike
- 5 Kapesi nr 1 i produktit
- 6 Kapesi nr 2 i produktit
- 7 Pucete ngjumbullimi produkti
- 8 Filter i shkarkimit te ujrave nga uji oil - water separator

SH 1.70	AI GLOBAL - OIL		
Punoi	Ing.A.Lutaj	API OIL - WATER SEPARATOR	2023
Kontrollor	K/Ing; R. Shehaj		

Figure 7 – Planvendosja e impiantit të trajtimit të ujrave

### **3. Perpunimi i mbetjeve vajore hidrokarbureve**

Shoqëria "Al Global Oil" Sh.a ka bërë Rishikimin e Kartës Teknologjike të Rafinerisë së Naftës. Ku tashmë përveçse perpunimit të naftës bruto ajo do të përpunojë edhe mbetjet vajore hidrokarbure, duke konsistuar në "Përpunimi i naftës bruto dhe mbetjeve vajore hidrokarbure.

Shoqëria "Al Global Oil" Sh.a do të përpunojë mbetjet vajore duke i futur keto te fundit per rikuperim në impiantin e rafinerisë.

Mbetjet vajore hidrokarbure do të jene : Vajra te ndotura anijesh dhe vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante.

Menaxhimi i këtyre mbetjeve do të realizohet në perputhje me kërkesat ligjore, nëpërmjet subjekteve të licensuara për transportin e tyre. Mbetjet vajore të gjeneruara nga industria portuale do të sillen ne cisterna në ambjentet e rafinerise dhe do te shkarkohen direkt në rezervuarin e grumbullimit të naftes bruto, e cila bashkë me të do ti nështrohet proceseve teknologjike nëpërmjet distilimit atmosferik, per perfitimin e nënprodukteve të naftës bruto dhe mbetjeve hidrokarbure (perfitimi i bitumit).

#### **Pershkrimi i perpunimit te naftes bruto dhe mbetjeve vajore hidrokarbure**

Mbetjet vajore te gjeneruara nga industria portuale do te sillen ne cisterna ne ambjentet e rafinerise dhe do te shkarkohen direkt ne rezervuarin e grumbullimit te naftes bruto, e cila pasi do te perzihet me kete te fundit do ti nenshtrohet proceseve teknologjike te rikuperimit/rafinimit dhe perftimit te nenprodukteve te saj (perfitimi i bitumit).

#### *Pershkrimi i linjes se Naftes Bruto dhe Mbetjeve Vajore*

Nafta bruto dhe mbetjet vajore te hidrokarbureve nga rezervuaret nepermjet pompave me avull, me piston dhe me presion dergohet perkatesisht ne seksionet A dhe B te fures FI AB. Lenda e pare tashme me temperature 40-70oC nepermjet linjave A dhe B futet ne tubot e konveksionit te poshtem e pastaj ne ato te konveksionit te siperm te fures ku ngrohet deri ne temperaturen 200°C. Prej konveksionit te siperm te fures lenda e pare (nafta bruto dhe mbetjet vajore) shkojne ne bllokun e dehidratoreve, ku realizohet ndarja e ujit nga nafta dhe mbetjet vajore. Lenda e dehidratuar dergohet ne zonen e poshtme te radiacionit te fures dhe pasi del prej saj kalon ne nje kolektor ku i bie presioni deri ne 2,5 atm dhe dergohet ne Kollonen e DistilimitAtmosferik.

#### *Pershkrimi i Procesit Teknologjik te Prodhimit te Holluesit*

Nga pjesa e sipërme e kollones Atmosferike te Distilimit, del holluesi, i cili kondensohet ne kondensatorin perkates dhe del prej andej me temperature 40°C. Nga kondensatori holluesi kalon ne seperatorin e ujit, ku nga pjesa e poshtme e tij shkarkohet vazhdimisht uji qe eshte ne perberje te holluesit ndersa ne pjesen e sipërme merret holluesi. Nga seperatori, holluesi, me ane te pompes centrifugale dergohet ne rezervuarin R5 te holluesit, ne Parkun e e Gjysem Produkteve

#### *Pershkrimi i Procesit Teknologjik te Prodhimit te Mazutit*

Mazuti del nga fundi i kollones se Distilimit Atmosferik, dhe futet ne pompen e mazutit, ku i rritet presioni jo me teper se 10 atm dhe pastaj dergohet per ngrohje ne furren F3, ku ngrohet deri ne 400-530°C dhe sipas rastit dergohet ose ne kollonen e vakumit, per te prodhuar bitum, ose dergohet ne ftohsin e mazutit, ku ftohet me uje deri ne 220°C. Nga ftohesi mazuti dergohet sipas nevojave te tregut ne rezervuaret R1,R2,R3,R4,R5 te Objektivit 5 qe eshte Reparti i Shitjes se Bitumit te lengshem dhe solarit.

#### *Pershkrimi i Teknologjiise se Prodhimit te Bitumit*

Bitumi eshte produkt i fundit te kollones se Vakumit, i cili pasi futet ne pompen e bitumit ku i rritet presioni jo me shume se 10 atm, ftohet ne ftohesin e bitumit me uje deri ne temperaturen 200-225°C dhe prej ketej dergohet ne repartin e Magazinimit, Shitjes se bitumit te lengshem. Hyrja e bitumit neper rezervuar behet nga siper nepermjet nje kolektori, qe i pershkon me radhe te gjithe rezervuaret.

Bitumi i grumbulluar ne rezervuare, pasi rezulton me karakteristika te rregullta, te percaktuara keto ne Laboratorin Kimik te Uzines se Perpunitimit te Naftes ne Fier, shkarkohet ne fuci, autobote, apo cisterna, me ane te dy pompave perkatese.

Bitumi nga kazanet me ane te kolektorit te brendshem me diameter 200 mm, i cili eshte i vendosur ne krah te sallave te bitumit, dergohet ne vaske, ku prej ketu, me anen e pompave te sallave dergohet, me pare, ne kolektorin e shperndarjes se bitumit dhe prej ketej me anen e tubacioneve, me diameter 100 mm, dergohet ne sallat e bitumit, ku nje pjese shkarkohet ne fuci dhe pjesa tjeter detyrimisht duhet te kthehet ne vaske nepermjet linjes se kthimit.

Kthimi i bitumit eshte i detyrueshem, per shkak te mbajtjes se linjave te shkarkimit te bitumit te ngrohta dhe te menjanimit te ngrirjes.

Nepermjet kolektorit te jashtem me diameter 150 mm bitumi shkarkohet me pare ne vaske dhe prej ketej me anen e pompave 2QYR30 112/25 te salles Nr.2 dergohet ne kolektorin e shperndarjes se bitumit, qe e dergon ate ne salle, per mbushjen e fucive, per ngarkim ne linjen me diameter 100 mm te ngarkimit te cisternave dhe autoboteve, si dhe ne rezervuar.

Mbetjet vajore hidrokarbure te cilat do ti nenshtrohen procesit te rikuperimit perkatesishtet i perkasin kodeve:

13 02 - Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante

13 04 -Vajra te ndotura anijesh.

Rikuperimi i mbetjeve vajore hidrokarbure do te kontribuojte ne permiresimin e gjendjes ekzistuese dhe mbrojtjen e mjedisit nga keq menaxhimi apo mos trajtimi i tyre.

#### **4. Informacion per qendrat e banuara**

Bashkia e re Fier, ne territorin e te ciles gjendet edhe zona e zhvillimit te projektit, shtrihet ne Ultesiren Perendimore, mes lumenjve Seman dhe Vlore. Ajo kufizohet ne veri me bashkinet Divjake, ne lindje me bashkitet Patos dhe Roskovec, ndersa ne jug me bashkinet Vlore.





Figure 8 – Njësitë Administrative të bashkisë Fier

Kjo bashki përbëhet nga dhjetë njësi administrative, të cilat janë: Fier, Çakran, Mbrostar Ura, Libofshë, Qendër, Dërmenas, Topojë, Levani, Frakull dhe Portëz. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.

Pjesa dërrmuese e bashkisë së re shtrihet në zonë fushore të ulët ndërsa komunat Çakran dhe Frakull kanë territor kodrinor.

### Demografia

Më 1 janar 2015 Bashkia Fier regjistroi një numër të popullsisë rezidente prej 122 mijë banorësh. Rreth 46% e popullsisë së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe 54% si popullsi rurale. Sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grup-moshës 15-64 vjeç dhe 20% grup-moshës 9-14 vjeç, tregues këto që demonstrojnë potencial të lartë të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e së cilës në tregun e punës do të ndikojë në rritjen e performancës ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente, si dhe moshja mesatare e saj, relativisht e re, tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.

Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë, por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.


Papunësia për Bashkinë Fier arrin 29.5%, e përafërt me mesataren kombëtare dhe lehtësisht më e lartë se Qarku Fier. Gjithsesi, në raport me bashkitë fqinje, bashkia Fier shënon shkallën më të lartë të papunësisë, me përjashtim të Patosit (49%). Ndërkaq, në nivel bashkie, papunësia më e lartë i takon njësiteve administrative Portëz dhe Qendër, të cilat ndodhen më pranë qendrës së Fierit. Papunësia prek më tepër femrat se meshkujt dhe pothuajse 50% të fuqisë punëtore të moshës 15-24 vjeç.

Të ardhurat për frymë dhe shpenzimet mesatare mujore të familjeve në nivel qarku dëshmojnë për mirëqenie më të ulët se qarqe të ngjashme. Mirëqenia sociale mbulohet pjesërisht nga disa institucione të kujdesit të rinjve e të moshuarve, dhe disa qendra kulturore e sociale në qytetin e Fierit. Bashkia Fier ka një situatë punësimi relativisht të mirë në raport me bashki të tjera të ngjashme, si Elbasani, Durrësi e Shkodra.

Niveli i përgjithshëm arsimor i popullsisë është jo i favorshëm, me 60-70% të popullsisë në njësitë administrative rurale që ka përfunduar vetëm arsimin fillor, dhe shkallë analfabetizmi të lartë në njësitë ku kemi prezencë populsië rome, si Qendër dhe Levan.

Shërbimi shëndetësor përbëhet nga 1 spital rajonal, 12 qendra shëndetësore dhe 85 ambulanca, të cilat mbulojnë nevojat e pjesës më të madhe të popullsisë. Në qytetin e Fierit gjenden shërbimet mjekësore të specializuara, si konsultore të fëmijës e nënës, poliklinika etj. Gjendja fizike e spitalit, poliklinikës dhe ambulancave nuk është e mirë dhe kërkon ndërhyrje rikonstruktuese.

Shëndeti publik në Bashkinë Fier rrezikohet nga sëmundjet diareike, kardiovaskulare, mundësitë e epidemive gastro-enterite për shkak të ushqimit, si dhe nga sëmundjet kancerogjene të frymëmarrjes për shkak të ndotësve të industrisë së naftës apo shpërthimeve aksidentale të gazit metan.



*Figure 9 – Pozicioni i zonës së zhvillimit të aktivitetit në lidhje me zonat e banuara*

## **Ekonomia**

Qarku i Fierit është një nga qarqet me nivelin më të lartë të Produktit të Brendshëm Bruto në Shqipëri. Evidentohet një mbizotërim i qartë i sektorit të shërbimeve në raport me sektorin e turizmit dhe atë të industrisë, pavarësisht potencialeve turistike që gjenden në territorin e bashkisë dhe faktit se industria është një nga sektorët me ndikimin më të madh në rritjen e Vlerës së Shtuar Bruto.

Fieri është njësi administrative që orientohet tërësisht drejt ekonomisë aglomeruese duke u bërë kështu një qendër e mirëfilltë shërbimesh për gjithë bashkinë e re. Në rastin e qytetit të Fierit, ekonomi dytësore është industria dhe tregtia.

Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Fierit për shkak të rë rezervave të mëdha të hidrokarbureve që gjenden në të. Përgjatë territorit të Bashkisë së re të Fierit do të kalojë edhe linja e gazsjellësit Trans-Adriatik, konkretisht në njësitë administrative të Mbrostarit, Libofshës, Topojës dhe Qendër. Gjithashtu projekti i TAP-it propozon edhe ndërtimin e një stacioni kompresor në Fier.

Qyteti i Fierit ka të zhvilluar një numër të madh biznesesh të mëdhenj dhe të vegjël. Rreth 75% e bizneseve të regjistruara në këtë Bashki janë biznese të vogla, ndërsa pjesa tjetër, 738 të tilla, janë biznese të mëdha. Më së shumti bizneset e mëdha gjenden në formën e njësive të importit dhe eksportit, njësive të shërbimeve, filiale bankash, restorante dhe bare, filiale me artikuj ushqimorë dhe industrialë, shërbime private shëndetësore, shërbime arsimore private dhe tregje private.

Përsa iu përket bizneseve të vogla, më së shumti dominojnë aktivitete në formën e linjave të transportit të udhëtarëve, restoranteve dhe bareve, supermarketeve, farmacive, parukerive, konfeksioneve, shërbimeve shëndetësore, serviseve të automjeteve dhe shitësve ambulanti.

Njësitë administrative Levan, Topojë, Portëz, Libofshë, Dërmenas dhe Mbrostar rezultojnë si njësitë më ndërvepruese me qytetin e Fierit.

Bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm në ekonominë e Bashkisë Fier. Fakti që më shumë se 55 për qind e popullsisë së bashkisë së re jeton në zonat rurale tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike të saj. Në territorin e bashkisë së re gjenden toka shumë pjellore, të cilat dikur kanë qenë kënetat dhe që sot janë të rrezikuara vazhdimisht nga përmytjet.

Edhe në Bashkinë e Fierit, ashtu si në të gjithë vendin, sektori bujqësor është përqëndruar fuqishëm rreth bujqësinë familjare. Në të gjithë bashkinë numërohen 24,667 ferma bujqësore dhe 374 ferma blegtorale. Njësitë administrative të Dërmenasit dhe Libofshës kanë numrin më të madh të fermave blegtorale, ndërsa njësi administrative e Frakullës ka numrin më të madh të serrave bujqësore. Fermat familjare janë kontribuesi më i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit, duke prodhuar ushqimin për vetë-konsum si dhe pjesërisht për treg. Kontributi i tyre në punësim është i rëndësishëm duke qënë se shumica e fermave individuale shërbejnë si burimi kryesor i të ardhurave për të vetëpunësuarit në këtë sektor. Prodhimi bujqësor i kësaj zone është i shumëllojshëm nga drithi të zarzavatet, bostanoret, blegtoria dhe nënproduktet e saj. Njësitë Mbrostar dhe Levan rezultojnë si njësi kyçe të pikave të grumbullimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore

Turizmi zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve nëpërmjet sigurimit të mundësive të punësimit, mirëqënies, infrastrukturës dhe aktiviteteve të ndryshme të shërbimit.

Duke iu referuar pasurive natyrore, pozicionimit pranë detit por edhe ekzistencës së monumenteve të kulturës, monumenteve të natyrës dhe zonave arkeologjike mund të thuhet se Bashkia e re e Fierit ka një potencial të madh turistik. Si potenciale turistike në këtë Bashki mund të përmendim: Parkun Arkeologjik të Apollonisë, Parkun e Levanit, rezervatin Natyror të Pishë-Poros dhe plazhet me rërë

përgjatë bregdetit si: plazhi ne Seman, Hidrovor, Pische-Poro, Darzezë etj. Nga ana tjetër një potencial turistik ngelen edhe grykëderdhjet e lumenjve: Vjosa, Shkumbin dhe Seman të cilët ofrojnë potenciale për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme natyrore. Zonat kënetore të pasura me florë dhe faunë diverse janë një potencial tjetër turistik për Bashkinë e re.

### **Infrastruktura rrugore**

Bashkia Fier ka lidhje shumë të mira me Vlorën, Patosin, Gjirokastrën dhe Lushnjën, me të cilat lidhet nëpërmjet autostradës “100-Vjetori i Pavarësisë” (Levan-Vlorë), rrugës Levan-Tepelenë, pjesë e Korridorit të Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane) si dhe autostradës Mbrostar-Levan<sup>1</sup>. Me Divjakën, Fieri lidhet nëpërmjet një degëzimi të rrugës Fier-Lushnje (pjesë e Korridorit VIII).

Rrugët urbane në Bashkinë Fier përbëjnë vetëm 11 km (të cilat shtrihen kryesisht në qytetin e Fierit), ndërsa 2964 km linear, të cilat shtrihen në periferi të qytetit dhe në territoret e njësive të tjera administrative, janë rrugë lokale. Ndër to, nga pikpamja e funksionit, mbizotërojnë rrugët bujqësore (56 % të totalit), ndjekur nga rrugët e brendshme dytësore (15 %). Pjesa më e madhe e rrugëve janë të pashtuara. Rrugët me cilësi të mirë shtrihen kryesisht në qytetin e Fierit, në një pjesë të qendrave të njësive rurale, si dhe në segmentet interurbane kryesore e dytësore.

### **Furnizimi me energji elektrike**

Furnizimi me energji elektrike realizohet nga rrjeti kombëtar i shpërndarjes së Energjisë elektrike.

### **Përdorimi i tokës në zonën e projektit**

Objekti UPN (Zona e zhvillimit të projektit) ndodhet brenda territorit të kompleksit industrial të Fierit dhe destinacioni i përdorimit të tokës prej dekadash ka qenë industrial dhe ekonomik.

## **5. Përshkrimi i Mjedisit Fizik**

### **5.1. Klima**

Bazuar në ndarjen klimatike të Shqipërisë, zona në të cilën gjendet UPN Fier bën pjesë në Zonën e Klimës Mesdhetare Fushore, e cila përfshin të gjithë pjesën e ulët dhe bregdetare të Shqipërisë. Regjimi klimatik është tipik mesdhetar dhe karakterizohet nga vera të nxehta dhe të thata dhe dimra të butë dhe të lagët.

I nxehti fillon që nga mesi i pranverës dhe vazhdon deri në fund të Tetorit. Klima e zonës së Fierit është e ngrrohtë, sepse ky qytet laget nga deti dhe nga lindja është i mbrojtur prej erërave të ftohta. Ky qytet dallohet për numrin e lartë të ditëve me diell 2850 orë në vit ose 240 ditë.

### **5.2. Temperatura**

Në regjimin e temperaturës së ajrit në këtë zonë ndikojnë disa faktorë, ndër të cilët brizat detare gjatë muajve të verës dhe erërat nga brendësia e territorit gjatë muajve të dimrit. Temperatura mesatare

---

<sup>1</sup>Dokumenti i Planit tëPërgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier

vjetore është 16.5°C dhe kemi të bëjmë me një regjim tipik mesdhetar ku temperatura minimale vërohet në muajin janar me 9.4°C, ndërsa temperatura maksimale vërohet në muajin korrik me 27.2°C. Sa lidhet me vlerat ekstreme të temperaturës mund të thuhet se ato luhaten në kufij të gjerë. Temperatura më e lartë e vërtetuar në këtë qytet është 40.8°C ndërsa temperatura më e ulët është -13.0°C.

Numri i ditëve në të cilat temperatura e ajrit tejkalon vlerën 35°C është 10 ditë/vit, ndërsa numri i ditëve në të cilat temperatura e ajrit bie nën kufirin -5.0°C është 1.5 ditë/vit. Më poshtë jepet grafiku i ecurisë vjetore të temperaturës së ajrit për qytetin e Fierit.




Figure 10 – Ecuria vjetore e temperaturës mesatare të ajrit (Fier)

Siç shihet nga grafiku, temperatura e ajrit ka një regjim tipik mesdhetar, me një maksimum në muajt e verës dhe minimum në muajt e dimrit.

### 5.3. Regjimi i reshjeve atmosferike

Sasia mesatare vjetore e reshjeve në rajonin e Fierit është nën mesataren e vendit. Shkak për këtë është relievi i ulët i cili, megjithë daljen në detin Adriatik, nuk i lejon masat ajrore detare të ngopura me lagështi të shkarkohen. Mesatarisht gjatë një viti në Fier bien 941.2 mm shi ndonëse në vite të veçantë sasia e reshjeve shmanget në mënyrë të konsiderueshme nga mesatarja.

Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë periudhës së ftohtë të vitit, ndërsa periudha e verës karakterizohet nga sasi të pakta reshjesh. Muajt më të lagësht janë nëntori dhe dhjetori, por nuk përjashtohen edhe muajt e tjerë, sipas rastit. Gjysma e ngrohtë e vitit karakterizohet nga reshje të pakta, ku veçohen muajt korrik dhe gusht, gjatë të cilëve bien mesatarisht 16-24 mm reshje.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë vjetore të sasisë së reshjeve si dhe numrit të ditëve me reshje (>=0.1 mm). Vihet re se, si sasia e reshjeve mujore ashtu dhe numri mesatar i ditëve me reshje paraqesin një regjim tipik mesdhetar. Muaji më i lagët i vitit është muaji nëntor gjatë të cilit bien mesatarisht 142.6

mm shi, ndërsa muaji më i thatë i vitit është muaji korrik gjatë të cilit bien mesatarisht 24.8mm shi. Respektivisht, numri i ditëve me shi ( $\geq 1$  mm) në këta dy muaj është 10.6 dhe 2.2 ditë.




Figure 11 – Ecuria vjetore e reshjeve dhe numrit të ditëve me reshje (Fier)

Duke pasur parasysh vlerat relativisht të larta të temperaturës së ajrit edhe gjatë stinës së dimrit, fenomeni i rënies së dëborës në këtë qytet është mjaft i rallë. Në Fier vrojtohen mesatarisht rreth 0.5 ditë në vit me reshje dëbore. Lartësia më e madhe e shtresës së dëborës të vrojtuar në këtë qytet është 7 cm. Kohëzgjatja e shtresës së dëborës, kur ajo krijohet, është mjaft e shkurtër. Ajo nuk i kalon 2-3 ditë.

#### 5.4. Regjimi erës

Era, në ndryshim nga elementët e tjerë të klimës, është një madhësi vektoriale. Ajo karakterizohet nga drejtimi dhe shpejtësia.

##### Drejtimi i erës

Në rajonin e Fierit, mesatarisht gjatë një viti, rastisjen më të madhe e kanë erërat që fryjnë nga drejtimi i juglindjes. Rastisja e këtij drejtimi është 22.8%. Drejtimi i dytë me rastisje më të madhe është ai i veriperendimit me rastisje 16.3%. Drejtimet me rastisjet më të vogla janë ato nga jugu, me rastisje vetëm 2.9% dhe nga veriu me 4.0%. Duhet theksuar që në qytetin e Fierit, mesatarisht gjatë një viti, në 22.7% të kohës nuk fryn erë (qetësi).

##### Shpejtësia e erës

Një tregues tjetër i rëndësishëm i regjimit të erës është shpejtësia e erës. Në përgjithësi qyteti i Fierit karakterizohet nga shpejtësi të vogla të erës. Shpejtësia mesatare vjetore e erës në Fier është 3.0 m/s. Në tabelën me poshtë paraqiten shpejtësitë mesatare për çdo muaj të vitit në qytetin e Fierit.

#### 5.4.1. Gjeomorfologjia dhe tokat

Në pikpamje të rajonizimit fiziko-gjeografik zona ku gjendet instalimi përfshihet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë. Terreni është fushor me kuotë mesatare rreth 30 m mbi nivelin e detit.

Tipi kryesor i tokave në zonë janë Tokat Aluvionale, të cilat janë toka të reja, pasi formohen në depozitime kryesisht të reja aluvionale lumore dhe detare, me teksturë të ndryshme. Ato janë të formuara në kushtet e relievit të rrafshët, me sope e gropa të vogla. Në profilin e këtyre tokave vërehet shtratifikim i aluvioneve dhe shpërndarje e çrregullt e lëndës organike. Pjesa më e madhe e tyre kanë profil të padiferencuar dhe shpërndarje të çrregullt humusi në thellësi. Janë toka me drenazh të dobët natyror, me nivel të lartë të ujërave nëntokësorë, që formojnë kore; një pjesë janë zhavorrishte dhe pothuaj jopjellore.

#### **5.4.2. Gjeologjia**

Zona në studim i përket periferisë jugore të Ultësirës Adriatike e cila në Albanide përfaqëson një ultësirë paramalore që shtrihet mbi zonat tektoniko - faciale të Sazanit, Jonike, Krujës dhe basenit të Adriatikut jugor.

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit ku ndodhet edhe zona e instalimit një rol të rëndësishëm luajnë formacionet molasike të Ultësirës Adriatike, ndërmjet të cilave veçohen depozitimet neogjenike të Miocenit të sipërm  $N_1^3$  m (Mesinianit), që përfaqësohen nga ndërthurja e argjilave dhe argjilave alevrolitore me trupa thjerrzore ranoresh me përhapje të kufizuar dhe forma gjenetike të tipeve kanalore. Me këto depozitime janë të lidhura të gjitha suitat naftëmbajtëse: Bubullima, Marinza, Driza, Gorani, Polovina-Kuçova si dhe një sërë shtresash ranorësh bituminozë.

Përhapje të konsiderueshme në zonën e instalimit kanë formacionet e Pliocenit të sipërm ( $N_2^{2rr}$ ), përfaqësuar nga depozitimet e suitës "Rrogozhina". Këto të fundit vendosen mbi pakon argjilore të formacionit "Helmasi" ( $N_2^{1h}$ ) dhe ndërtohen nga ranorë, gravelite, konglomeratë me ndërshtresa të holla argjilash.

Pak më shumë se gjysma e sipërfaqes së rajonit mbulohet nga depozitimet e Kuarternarit ndër të cilat janë veçuar tipet gjenetike detare, lagunore, kënetore, aluvionale të shtretërve të lumenjve, aluviale të tarracave dhe depozitimet e përziëra kolumiale – deluviale – proluviale.




Figure 12 – Harta gjeologjike e zonës së UPN

### 5.4.3. Tektonika

Në fund të Miocenit ndodhi rrudhosja e lehtë e formacioneve miocenike të Ultësirës Adriatike, ndërsa në fillim të Pliocenit, filloi tërheqja dhe zhytja e tyre, shoqëruar me grumbullime të fuqishme të molasave pliocenike. Nga fundi i Pliocenit, si rezultat i kompresionit të fuqishëm ndodhi rrudhosja përfundimtare e Ultësirës në të cilën u formuan strukturat rrudhosese e shkëputëse të saj.

Në zonën e instalimit takohet vazhdimi i monoklinalit Selenicë-Cakran-Kreshpan, i cili ndërtohet nga formacionet pliocenike. Vargu më perëndimor është ai i Povelçë-Semanit. Ngritja e Povelçës paraqitet në formën e një hunde strukturore për depozitimet e Miocenit të sipërm-Pliocenit. Me në veri vazhdon me ngritjen e Semanit dhe me shkëputje në pjesën prankulmore.

## 5.5. Ujërat

### 5.5.1. Ujërat sipërfaqësorë



Zona përreth është e varfër në burime ujore sipërfaqësore. Rreth 1 km në lindje të uzinës rrjedh lumi i Gjanicës i cili është një nga afluentët e Semanit. Gjanica buron në veri të kodrave të Allkomenajt, dhe pasi rrjedh nëpër një relief kodrinor përgjatë zonës së Mallakastrës, futet në qytetin e Fierit dhe në veri të tij, pranë fshatit Mbrostar, bashkohet me Semanin dhe të dy derdhen në detin Adriatik, ku formojnë një deltë të madhe. Gjanica ka një gjatësi prej 42 km dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 234.07 km<sup>2</sup>. Në lumin e Gjanicës derdhen shumë lumenj si ai i Lapulecit, Gjinaqarës etj. Ushqimi kryesor i Gjanicës janë reshjet në formën e shiut, prandaj prurjet më të mëdha ky lumë i ka në stinën e lagësht të vitit. Prurja e lëngët mesatare vjetore është 2 m<sup>3</sup>/s. Në regjimin hidrologjik të Gjanicës ndikon përbërja litologjike e pellgut, prania e shkëmbinjve të papërskueshëm, mbulesa bimore e varfër, karakteri i copëtuar i relievit dhe kushtet klimatike, veçanërisht, reshjet e shiut. Në kohë reshjesh të shumta dhe me rrebes, Gjanica përmbyt pjesën lindore të qytetit të Fierit.




Figure 13 – Zona e zhvillimit të aktivitetit në lidhje me burimet ujore

Aktualisht Gjanica vazhdon të jetë një ndër dy lumenjtë më të ndotur të vendit, klasifikuar në kategorinë e pestë. Gjanica mbledh të gjitha ujërat e industrive të rrethit të Fierit, zonës së Ballshit, zonë në të cilën është edhe përqendrimi më i madh i puseve të naftës.

### 5.5.2. Ujërat nëntokësorë

Referuar hartës hidrogeologjike të zonës në të cilën gjendet zona e projektit vërehet se ai shtrihet mbi zonë jo akuifere. Në rajonin përreth saj mbizotërojnë ujërat nëntokësore të depozitimeve kuaternare të lumit të Vjosës. Cilësia e këtyre ujërave është e mirë dhe brenda normave të lejuara të ujit të pijshëm. Ujërat janë të llojit të poreve dhe furnizojnë qendrat e populluara të luginës së Vjosës si dhe qytetin e Fierit dhe të Patosit nëpërmjet burimeve kryesore që gjenden në Varibop, Kafaraj etj. Në zonën kodrinore të Mallakastrës kanë përhapje më të kufizuara.




Figure 14 – Harta hidrogjeologjike e zonës

### 5.6. Mjedi biologjik

Uzina e përpunimit të Naftës është e ndërtuar brenda kompleksit Industrial të qytetit të Fierit, i cili gjendet në juglindje të qytetit. Veprimtaria prej disa dekadash në këtë zonë e TEC-it, ish Azotikut dhe UPN-së, por edhe zhvillimet e dy dekadave të fundit, tregojnë shkallën e lartë të ndërhyrjes humane në të, fakt i cili ka çuar në tjetërsim të habitateve natyrore. Për rrjedhojë zona është e varfër në vlera të biodiversitetit. Habitatet që përshkruhen në këtë paragraf mbulojnë kryesisht terrenet që shtrihen në jug dhe lindje të të zonës. Pjesa tjetër kufizohet me qytetin e Fierit.

Zona dominohet nga toka bujqësore dhe terrene të tjetërsuara për qëllime bujqësore dhe pasuria biologjike e saj konsiderohet përgjithësisht e ulët. Habitatet dominuese përfshijnë:

- Terrene gjysëm-natyrore (toka bujqësore të braktisura);
- Terrene të brigjeve të rrjedhave ujore dhe kanaleve kulluese;
- Terrene bujqësore (toka bujqësore në kultivim).

### 5.7. Zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore

Zonat e mbrojtura bashkë me monumentet e natyrës përfaqësojnë një rrjet sipërfaqesh që mbrohen në shkallë të caktuar, sipas përcaktimeve kategorike të tyre, për shkak të vlerave natyrore kombëtare, por edhe rajonale e globale.

Referuar hartës së Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, publikuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura<sup>2</sup>, dhe duke konsideruar faktin që objekti është ekzistues dhe ndërtuar në një zonë industriale, është e qartë që nuk ndërpret asnjë zonë të mbrojtur.

<sup>2</sup>[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=item&layout=item&id=68&Itemid=368&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=68&Itemid=368&lang=en)

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për monumentet e natyrës.




Figure 15 – Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me zonat e mbrojtura

Sic mund të shikohet edhe nga figura e mësipërme, implementimi dhe zhvillimi i projektit të propozuar dhe zonat e mbrojtura përreth saj janë në një distancë të konsiderueshme nga njëra-tjetra. Zona e UPN ndodhet në një distancë prej 13 km në vijë ajrore nga Rezerva Natyrore e Menaxhuar e Pishë- Poro dhe në një distancë prej 9.2 km nga Parku Komëtarë i Vjosës.

Nga zhvillimi i projektit këto zona të mbrojtura nuk do të preken, kjo për arsye të vendndodhjes dhe distancës së tyre.

## 6. Informacionin për infrastrukturën e nevojshme

**(për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;)**

Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN) Fier gjendet brenda territorit të kompleksit industrial të qytetit të Fierit, i cili vendoset në pjesën jugperendimore të qytetit, rreth 1.2 km në dalje të tij. I gjithë kompleksi ka akses me rrugën nacionale Fier-Vlorë nëpërmjet një degëzimi të saj në të majtë, rreth 200 m në dalje, nëpërmjet rrugës së Azotikut. Gjendja ekzistuese e gjithë infrastrukturës rrugore paraqitet e mirë.

Ne dhjetor të vitit 2017, pas një periudhe kohe jashtë operimit, uzina e përpunimi të naftes kaloi ne pronësi të subjektit “Al Global Oil” Sh.a, e cila aktualishtë ushtron aktivitetin në uzinën e përpunimit të naftës bruto, dhe është pajisur me Leje Mjedisore Tipi A me PN-6510-05-2018 pajisur me Akt-Miratimi të Lejes A Nr. 3464 Prot, datë 09.04.2019, nr. i identifikimit te lejes 2788/1, K.Nr. 18.

Zona e ushtrimit të aktivitetit prej dekadash ka qënë një zonë industriale dhe ekonomike. Furnizimi me energji elektrike për funksionimin e impiantit do të realizohet nga rrjeti ekzistues me të cilin operon aktualisht shoqëria. Gjithashtu edhe furnizimi me ujë.

Mbetjet urbane do të menaxhohen në konteneret aktual të menaxhimit të tyre, të cilët ndodhen në afërsi të zonës së zhvillimit të projektit/impiantit të ri. Pas depozitimit të tyre në kontenerët përkatës, menaxhimi dhe transportimi i mbetjeve urbane kryehet nga pushteti vendor, bashkia Fier. Si destinacion final qëndron landfilli/inceneratori i Fierit.

Kurse mbetjet e gjeneruara nga procesi i pastrimit/remontit, larja e filtrit, gjenerimi i llumrave, apo pastrimi i pjesës fundore të impiantit quajtur ndryshe zona e baltrave. Menaxhimi i këtyre mbetjeve do të menaxhohet nëpërmjet grumbullimit të tyre në depozitën e dedikuar të ujrave teknologjike, ujëra dhe rryma këto të menaxhuara nga subjekti i licensuar për këtë qëllim. Llumrat kanë përmbajtje hidrokarburesh, uji me një pjesë emulsionesh/hidrokarburesh. Si ujërat teknologjike të gjeneruara nga procesi si edhe rrymat e këtyre mbetjeve do të menaxhohen konkretisht nga subjekti "Terraoil Sëiss" Sh.a ku shoqëria ka lidhur në kontratë për menaxhimin e tyre.

Persa i perket funksionimit të UPN pas punimeve për remontin e reparteve të amortizuara, nga procesi teknologjik gjenerohen vetëm rrymat e meposhtme të mbetjeve:

- Ujra teknologjike;
- Mbetje hidrokarbure;

Te cilat sipas rrymave klasifikohen me kodet e mëposhtme:

05 01 06 \* - Llumra të naftës që dalin nga operacionet e mirëmbajtjes së impiantit apo pajisjeve

05 01 17 – Përzierje bituminoze

05 01 99 – Mbetje të tjera të paspecifikuara

19 02 06 – Llumrat nga trajtimi fiziko-kimik, të tjera të përmendura në 19 02 05.

## **7. Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit**

**(kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit)**

Sic e kemi cituar edhe ilustruar më sipër, shikohet së pjesa më e madhe e punimeve ndërtimore për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujrave ka përfunduar. Për këtë arsye pjesa e mbetur e punimeve ndërtimore dhe instalimi i pjesëve për funksionimin e impiantit do të zgjasin për një periudhë 2-3 javore. Kjo është koha normale që duhet për të përfunduar ndërtimin/instalimin e Impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura hidrokarbure, në kushte normale. Kjo periudhë është e vlefshme në kushte teknike, juridike e klimë normale, por në rast se do të hasen vështirësi gjatë punimeve mund të ketë edhe shtyrje të afatit. Por gjithësesi ndikimet e fazës ndërtimore do të jenë të kufizuara kjo për arsye se ato në pjesën më të madhe kanë përfunduar.

Përsa i përket ndikimeve gjatë fazës së funksionimit ato do të jenë prezente për atë kohë sa do të përdoret edhe impianti. Por këto ndikime po ti krahasojmë me fazën e funksionimit të impiantit ekzistues, impianti i ri do të shoqerohet me ndikime më të kontrollueshme dhe afatshkurtra. Pasi në impiantin e ri do të bëhet i mundur identifikimi i saktë i ndikimeve, dhe shmangia e shkarkimeve të ujrave të ndotur në lumin e Gjanicës.

#### **8. Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;**

Lëndët e para të cilat do të përdoren gjatë funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave, do të jenë:

- Energji elektrike.
- Ujërat sipërfaqësorë të shirave dhe ujrat larës të instalimi në tërësi, të cilat do të trajtohen në impiant.

Kurse persa i perket lendeve te para qe perdoren per prodhimin/perpunimin e naftes bruto dhe mbetjeve vajore hidrokarbureve, do te jene:

- Nafta bruto
- Mbetjet vajore hidrokarbure te cilat do te gjenerohen nga industria portuale, te cilat do te bashkohen ne rezervuarin e grumbullimit te naftes bruto.
- Lende djegese (Solar e cila perdoret per furat pergjate fazes se pepunimit)
- Uje.
- Hollues,etj;

#### **9. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS**

Në këtë seksion analizohen ndikimet që shkaktohen nga zhvillimi i projektit të propozuar. Analiza e ndikimeve shërben për të parashikuar ndikimet e mundshme të aktivitetit në mjedis si dhe vlerësuar shkallën/rëndësinë apo madhësinë e tyre në raport me vlerat mjedisore që dëmtohen nga ndikimet. Rëndësia e çdo ndikimi apo pasoja e tij në receptorin apo zonën e ndikuar është vlerësuar dhe kategorizuar bazuar në probabilitetin që ndikimi të ndodhë, llojin i ndikimit, kohëzgjatjen e ndikimit, shkallën e ndikimit dhe mundësinë për të zbutur pasojat e ndikimit.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e projektit të propozuar është bërë duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e tij, teknologjinë e përdorur, mënyrën e trajtimit, cilësinë dhe rrymat e ujrave që do trajtohen në impiantin e ri (ujërat sipërfaqësorë të shirave dhe ujrat larës të instalimit), si dhe ndryshimi dhe rishikimi i kartes teknologjike të rafinerisë "Perpunimi i naftes bruto dhe mbetjeve vajore hidrokarbure".

##### **9.1. Metodika e aplikuar për vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis**

Në këtë seksion janë identifikuar ndikimet e mundshme që do të ketë në mjedis zbatimi i projektit të propozuar për ndërtimin e impiantit të ri të trajtimit të ujrave të ndotura në funksion të aktivitetit të shoqërisë "AL GLOBAL OIL" Sh.a, si dhe rishikimi i kartes teknologjike ku përfshihen perpunimi i naftes

bruto subjekti do te futi per rikuperim ne impiant dhe mbetjet vajore hidrokarbure. Për identifikimin e ndikimeve të pritshme të projektit dhe pasojave në mjedisin fizik dhe social është zbatuar metodika dhe procedurat e mëposhtme:

- Njohja me ciklin e plotë të aktivitetit dhe identifikimi i operacioneve që kanë ndërveprim me mjedisin në secilën fazë të zhvillimit të tij;
- Inspektimi në terren i zonës së propozuar për zhvillimin e projektit dhe vlerësimi i mjedisit dhe vlerave natyrore të saj;
- Evidentimi i faktorëve favorizues dhe kufizues për zhvillim e aktivitetit, të cilët ndikojnë në shfaqjen e ndikimeve të mundshme në mjedis.
- Përcaktimi i receptorëve më të ndjeshëm mjedisorë;
- Identifikimi i ndikimeve të mundshme dhe me pasoja të rëndësishme në mjedis për çdo operacion (sipas fazave), bazuar edhe në studimin e gjendjes së mjedisit;

#### 9.1.1. Ndikime të mundshme gjatë fazës së funksionimit

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit te naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
1	Cilësia e ajrit	<p>Përgjatë fazës së funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave nuk do të kemi shkarkime të emetimeve në ajër.</p> <p>Emetimet e gazeve në këtë fazë mund të lidhen vetëm me lëvizjen e automjeteve dhe qarkullimin e tyre në funksion të aktivitetit.</p>	<p>Përgjatë fazës së funksionimit të impiantit te trajtimit te ujrave ky ndikim nuk do të konsiderohet.</p> <p>Emetimet e gazeve ne kete faze te projektit do te jene ato te funksionimit te fabrikes per perpunimin e naftes dhe mbetjeve vajore.</p> <p>Ky ndikim do te jete i njejete me situaten aktuale. Pasi mbetjet vajore do te bashkohen me lenden e pare naften bruto dhe do te futen ne impiant per perftimin e bitumit.</p>
2	Zhurme	Zhurme e gjeneruar nga pjesët e impiantit (pompa, kapësi	Gjithsesi ky ndikim nuk do të jetë i ndjeshëm, dhe nuk do të

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
		<p>mekanik i hidrokarbureve etj.).</p> <p>Zhurme e gjeneruar nga funksionimi i fabrikes.</p>	<p>konsiderohet kurr si shqetësim.</p> <p>Persa i perket gjenerimit të zhurmes nga funksionimi i fabrikes për perpunimin e naftes bruto dhe vajrave vajore, ai do të jetë i njëjti me situatën aktuale. Subjekti vazhdon zbatimin e kushteve të lejes mjedisore duke kryer në mënyrë periodike monitorimin e parametrave ku një ndër to edhe monitorimi i zhurmave. Ku nga rezultatet e analizave niveli i zhurmave përgjatë fazës së funksionimit është me i ulët se vlerat kufi.</p>
3	Cilësia e ujërave	<p>I vetmi ndikim i cili mund të ndikojë dhe prekë cilësinë e ujrave, është mos funksionimi i impiantit, dhe shkarkimi i tyre në mjedisin prritës.</p> <p>Sic e kemi shpjeguar edhe më sipër në impiantin e ri të trajtimit të ujrave të ndotur do të trajtohen ujërat sipërfaqësorë të shirave dhe ujërat larës të instalimi në tërresë (larja e linjës teknologjike). Pasi duke qënë se këto ujra në shumicën e rasteve kur behet larja e linjës teknologjike kanë përmbajtje të lëndëve hidrokarbure, do të dërgohen për trajtim në impiant.</p> <p>Mos funksionimi i impianti dhe</p>	<p>Në impiantin e ri të trajtimit të ujrave nuk do të kemi përdorim të lëndëve kimike ndihmëse, pasi në këtë impiant do të kemi të bëjmë me një proces fizik me ndarje.</p> <p>Në pjesën e sipërme të impiantit do të vendoset një kapës i cili do të bëjë të mundur kapjen e hidrokarbureve që do të flotojnë në pjesën e sipërme të ujit, më pas hidrokarburet e kapura në pjesën e sipërme do të grumbullohen për tu rifitur sërisht në procesin teknologjik për tu përdorur si hollues.</p> <p>Ujërat e depozituara në këtë impiant do të quhen të trajtuar pasi të nënshtrohen fazës përfundimtare të trajtimit i cili është procesi i</p>

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
		<p>shkarkimi i ujrave të pa trajtuar në sistemin e kanalizimeve do të konsistonte në ndotje dhe prishje të cilësisë së ujit.</p> <p>Kurse ujrave të ndotura me hidrokarbure të cilat gjenerohen nga procesi teknologjik, grumbullohen në një depozitë të dedikuar dhe trajtohen nëpërmjet kompanisë Terra Oil Swiss, ku shoqëria ka lidhur kontratë me këtë të fundit për menaxhimin dhe trajtimin e tyre.</p> <p>Në asnjë rast nuk duhet të kemi depozitim të këtyre ujrave në impiantin e ri të trajtimit.</p>	<p>filtrimit. Pas procesit të filtrimit ujrave do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve.</p> <p>Ujërat pas shkarkimit të tyre do të kenë njolla të lehta me hidrokarbure/emulsioni të cilat do të korisposojnë brenda normave të lejuara.</p> <p>I vetmi ndikim i cili mund të ndikojë cilësinë e ujrave është mos funksionimi i impiantit, dhe shkarkimi i ujrave të patrajtuar nga keqmenaxhimi në ujërat pritës.</p> <p>Impianti i ri ndryshe nga impianti ekzistues nuk do të ndikohet nga faktorë të tjerë të jashtëm, sic ndodhte shpesh me impiantin ekzistues, ku nën ndikimin e kushteve atmosferike lumi i Gjanicës përziej me ujërat e patrajtuara të impiantit.</p> <p>Ndikimi në këtë fazë do të quhet i ulët i cili mund të kontrollohet dhe shmanget me masat e duhura të menaxhimit.</p>
4	Toka	Rrjedhje aksidentale të ujrave të patrajtuar me përmbajtje hidrokarbure të cilët mund të kontaminonin tokën.	Mundësia për të ndodhur ky ndikim përgjatë fazës së funksionimit është shumë i ulët, pasi ujërat e sipërfaqësorë të shirave dhe ujrave të largës së linjës teknologjike do të shkojnë në sistemin e brendshëm të kanalizimeve të uzinës të cilat do të grumbullohen në pusëtën



Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>përmbledhëse dhe më pas do të shkojnë në impiantin e trajtimit. Pra i gjithë procesi është i përbërë nga një rrjet i brendshëm kanalizimesh. Një ndodhi aksidentale si dëmtim i sistemit të brendshëm të kanalizimeve mund të behët objekt ndikimi, ku ujrat e ndotura mund të prekin dhe bien në kontaktë me tokën.</p> <p>Mundësia për një ndikim të tillë do të jetë shumë e ulët, dhe ky ndikim mund të quhet si i tillë.</p> <p>Kurse përse i përketë mundësisë së mundshme nga shkarkime aksidentale të karburantëve/lubrifikantëve të ndryshëm nga automjetet të cilat lëvizin në sipërfaqen e ushtrimit të aktivitetit, mund të themi se sheshet e lëvizjes së tyre janë të shtruara me beton dhe asfalto/beton dhe përkundrazi janë të pajisura me një sistem drenazhimi i cili lidhet me sistemin e kanalizimeve. Prandaj përsëri po them se ky ndikim për një depërtim në tokë pothuajse nuk do të ekzistojë.</p>
5	Flora & Fauna	Shqetësim dhe largim i mundshëm i llojeve të faunës si rezultat i zhurmave dhe gazeve.  Rrjedhje aksidentale dhe dëmtim kontaminim i	Përse i përketë shqetësimit dhe largimit të faunës në afërsi të zonës së zhvillimit të projekti, mendoj se ky ndikim nuk mund të quhet si i tillë për disa arsye:

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftës bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
		florës/faunës.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zona e zhvillimit të projektit është pjesë e uzinës së përpunimit të naftës UPN, që do të thotë se kemi të bëjmë me një zonë 100% industriale. Ku gjatë funksionimit të aktivitetit nga procese të ndryshme mund të kemi emetimeve të zhurmave/emetime këto brenda normave dhe standarteve të lejuara, por që në raste dhe momente të vecanta mund të behen objekt shqetësimi për largimin e faunës.</li> <li>2. Funksionimi i impiantit të trajtimit të ujrave në vetëvete është një proces i cili nuk shoqërohet me emetime të zhurmave. Emetimet e zhurmave që do të shoqërojnë këtë projekt përgjatë fazës së funksionimit janë funksionimi i pompës, e cila do të këtë një emetim zhurme si cdo lloj pompe tjetër, dhe emetime nga zhurmat nga procesi mekanik i trajtimit, që përsëri edhe ky ndikim i mundshëm do të konsiderohet i papërfillshëm.</li> <li>3. Gjthashtu emetimi i zhurmave nga funksionimi i rafinerisë për perpunimin e naftës bruto dhe mbetjeve vajore do të jete i njejte me situaten aktuale. (subjekti gjatë monitorimeve në</li> </ol>

Faza e funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>mënyrë periodike të cilat kryhen në funksionë të lejes mjedisore për funksionimin e aktivitetit/uzinës, vlerat dhe nivelet e zhurmave janë konstatuar brenda normave dhe standarteve të lejuara.</p> <p>Impianti i ri i trajtimit të ujrave të ndotura nga pikëpamja teknike po ndërtohet në përputhje me cdo standart dhe cilësi ndërtimi, dhe për këtë arsye ngjarjet aksidentale për shkak të kushteve teknike, nuk do të ndodhin. Ndryshe kjo nga impianti ekzistues ku amortizimi i tij në vite ka lënë vend për incidente me karakter të njëjtë.</p> <p>Sic e kemi cituar edhe më lartë impianti i ri i trajtimit të ujrave të ndotura nga pikëpamja strategjike po ndërtohet në një pozicion më të favorshëm se impianti ekzistues, kjo për shumë faktorë të ndryshëm ndikimi të cilat në vite kanë shoqëruar atë ekzistues në lidhje me gjendjen e komponentëve mjedisorë.</p> <p>Vërshimet dhe dalja në mënyrë të vazhdueshme e lumit Gjanica nga shtrati duke përzier ujrën e tij më ato të impiantit të trajtimit, ka çuar shpesh në dëmtim të florës, apo faunës ujore të lumit Gjanica. Prej më shumë se disa dekadash industria e naftes e ka modifikuar tërësisht</p>

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftës bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>mjedisin ekologjik të zonës. Fauna ujore e lumit Gjanica pothuajse nuk ekziston pasi cilësia e tij për shumë arsye konsiderohet si lumi më i ndotur me parametrat më të lartë dhe kategorinë më të keqe të tij.</p> <p>I vetmi ndikim që mund të konsiderohet si i tillë dhe të bashkangjitet faktorëve të mësipërm është mosfunksionimi i impiantit dhe shkarkimi i ujrave të patrajtuar në sistemin e kanalizimeve dhe më pas kontakti i tyre me burimet ujore pritëse. Edhe pse cilësia e këtyre ujrave është e një karakteri ndryshe nga ujrat teknologjike, prap cilësojmë se shkarkimi i tyre në mënyrë të patrajtuar në mjedis bëhet objekt ndikimi.</p> <p>Por duke vlerësuar të gjithë infrastrukturën e impiantit të ri trajtimit ndikimi në këtë fazë do të konsiderohet i ulët/i papërfillshëm.</p> <p>Nuk duhet të harojmë se subjekti në mënyrë periodike në zbatim të kushteve të lejes mjedisore kryhen inspektimet vizuale në zonën e ushtrimit të aktivitetit si dhe monitorimet e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe ato të kanalizimeve. Edhe përgjatë funksionimit të impiantit në ndryshimet e kushteve të lejes me</p>

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>funksionimin e impiantit të ri konsulenti mjedisorë do të përcaktojë pikat e shkarkimit dhe monitorimit, për të vlerësuar cilësinë e ujrave para dhe pas trajtimit të tyre në impiantin e ri, për të lëjuar më pas shkarkimin e tyre në sistemin e kanalizimeve apo burimet ujore pritëse.</p> <p>Funksionimi i impiantit të ri të trajtimit të ujrave të ndotura do të ndikojë në mënyrë pozitive në gjithë procesin e saj.</p>
6.	Mbetjet	<p>Rrymat kryesore të gjenerimit të mbetjeve gjatë funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura.</p> <p>Mbetjet e gjeneruara nga procesi i perpunimit të mbetjeve vajore dhe naftes bruto.</p>	<p>Po e nis me mbetjet urbane, në këtë fazë të funksionimit të impiantit të trajtimit, mbetjet urbane do të menaxhohen si gjithë mbetjet e tjera urbane gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë. Pra ky instalim nuk do të shoqërohet me mbetje shtesë/individuale, pasi zhvillimi i këtij projekti do të jetë si një derivat i uzinës. Për këtë arsye menaxhimi i tyre do të jetë po i njejtë i cili do të menaxhohet nëpërmjet kontenerëve të vendosur, i cili më pas do të konsistojë në transportin e tyre nga ana e pushtetit vendor, për tu depozituar në destinacionin final, landfillin/inceneratorin e Fierit.</p> <p>Kurse ajo që do të ketë më rëndësi përgjatë kësaj faze do të jenë</p>

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftës bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>mbetjet e gjeneruara nga procesi i pastrimit/remontit, larja e filtrit, gjenerimi i llumrave, apo pastrimi i pjesës fundore të impiantit quajtur ndryshe zona e baltrave. Menaxhimi i këtyre mbetjeve duke përfshirë edhe mbetjet nga procesi i perpunimit do të menaxhohet nëpërmjet grumbullimit të tyre në depozitën e dedikuar të ujrave teknologjike, ujëra dhe rryma këto të menaxhuara nga subjekti i licensuar për këtë qëllim. Llumrat kanë përmbajtje hidrokarburesh, uji me një pjesë emulsionesh/hidrokarburesh. Si ujërat teknologjike të gjenruara nga procesi si edhe rrymat e këtyre mbetjeve do të menaxhohen konkretisht nga subjekti "TerraOil Sëiss" Sh.a ku shoqëria ka lidhur në kontratë për menaxhimin e tyre.</p> <p>Ky ndikim do të shmangët dhe kontrollohet/menaxhohet nëpërmjet masave të duhura të menaxhimit/subjekti i licensuar për këtë proces.</p> <p>Keq menaxhimi i këtyre rrymave/mbetjeve nuk duhet të bëhet në asnjë rast objekt ndikimi për komponentët mjedisorë.</p>
6	Mjedisi socio - mjedisor	Ndërtimi dhe funksionimi i impiantit të ri të trajtimit të ujrave do të shoqërohet vetëm	<p>Ndikimi socio – mjedisor do të jetë mjaft pozitiv, për disa arsye:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Impianti ekzistues i trajtimit</li> </ol>

Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftes bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
		me ndikime pozitive.	<p>të ujrave është vlerësuar dhe gjykuar si një impiant me efikasitet dhe rendiment jo të lartë trajtimi.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Impianti ekzistues është në funksion të disa subjekteve, dhe nuk përcakton saktë identifikimin e ndotjes.</li> <li>3. Impianti ekzistues ndodhet jashtë zonës së funksionimit të aktivitetit/instalimit. Pozicioni strategjik i tij nuk paraqet kushte të favorshme sa impianti i ri.</li> <li>4. Në impiantin e ekzistues i cili ndodhet jashtë instalimit trajtohen edhe ujra të tjera të ndotur, pra kemi të bëjmë me një impiant gjithëpërfshires që mirëpret rryma të ndryshme, dhe jo një impiant individual.</li> </ol> <p>Për këto arsye subjekti ka projektuar ndertimin dhe funksionimin e impiantit të ri, i cili do të jetë një impiant individual, i cili do të trajtojë vetëm ujra sipërfaqësorë të shirave dhe ujrave të larës të linjës teknologjike dhe jo ujrave teknologjike, apo ujra me karakter tjetër.</p> <p>Tashmë impianti i ri i trajtimit të ujrave do të ndërtohet në brendësi të zonës së ushtrimit të aktivitetit/UPN.</p> <p>Vendndodhja strategjike e tij konsiderohet dhe vlerësohet më e</p>

Faza e funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit të naftës bruto dhe mbetjeve vajore.			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>favorshme se ajo ekzistues.</p> <p>Impianti i ri nuk do të kthehet më si një hotspot në ndikimin e ujrave të lumit Gjanica.</p> <p>Në impiantin e ri do të kemi një identifikim më të saktë të ndotjes i cili do të ndihmojë për të përcaktuar më pas shkakun e saktë dhe propozuar masat e duhura menaxhuese të ndikimit.</p> <p>Gjendja teknike e impiantit të ri do të jetë më e mirë se ajo ekzistuese.</p> <p>Faktorët e ndryshëm të jashtëm nuk do të ndikojnë impiantin e ri.</p> <p>Ndërtimi i impiantit të ri do të kontribuojë në mbrojtjen dhe zbutjen e shkarkimeve ndotes mbi mbjedisin.</p> <p>Impianti i ri i trajtimit të ujrave do të reflektohet në ndryshimet e lejes mjedisore, ku në zbatim të kushteve të tij impianti do të nënshtrohet monitorimit periodik, për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e ujrave para dhe pas trajtimit, e për të vlerësuar më pas shkarkimin e tyre në sistemin e kanalizimeve/burimet ujore pritëse.</p> <p>Por si pasojë e investive të bëra qoftë në zëvendësimin e pajisjeve, makineritë të dëmtuara apo në përmirësimin e linjave teknologjike,</p>



Faza e funksionimit të impiantit të rajtimit të ujrave të ndotura dhe rafineria e perpunimit te naftes bruto dhe mbetjeve vajore.

Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
			<p>rezervuarai P-7, impianti i trajtimit te ujrave, investime këto të cilat kanë ndikuar ndjeshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e rendimentit dhe eficencën prodhuese /perpunese të fabrikës (ku deri më tani kapaciteti i instalimit arrinte ne 40% te kapacitetit te plote te saj, kjo për shkak edhe të mungesë së lëndës së parë). Per kete arsye investimet e realizuara nga ana e shoqerise kane sjelle ndryshimet e meposhtme:</p> <p>1-Zvogëlimin me 90 – 95% te hidrokarbureve qe mbeten ne ujrat teknologjike sikurse edhe mbetjeve te tjera te cilat rikthen ne instalim per tu trajtur qofte si lende djegëse ,qofte per tu futur serisht ne procesin e përpunimit.</p> <p>2- Eleminimin e shkarkimit te ujrave teknologjike ne mjedis;</p> <p>3- Eleminimin e mbetjeve te listuara ne Shtojcen 4.1 te Akt-Miratimit Nr. 3464 Prot, datë 09.04.2019, nr. i identifikimit te lejes 2788/1, K.Nr. 18 te lejes mjedisore me PN-6510-05-2018.</p>

*Të gjithë komponentët e mësipërm mjedisorë do të vlerësohen duke u raportuar në raportet periodikë dhe vjetor të monitorimit pas ndryshimeve te propozuara ne lejen mjedisore, ku këta të fundit do të paraqesin të dhënat për vlerësimin e vlerave të shkarkimeve në ajër, toke, ujë, zhurma, apo mbetje.*

### 9.1.2. Sinjifikanca e ndikimeve

Vlerësimi i sinjifikancës së ndikimeve nënkupton sa ushtron veprimtaria e propozuar ndikim në mjedisin natyror dhe socio-mjedor brenda konceptit kohë dhe është një ndër aspektet më të rëndësishme për të gjykuar mbi të. Qëllimi për të cilin u vlerësua sinjifikanca e ndikimeve është vlerësimi i veprimtarisë në mënyrë objektive, propozimi i masave efektive për minimizimin e ndikimeve thelbësore.

*Tabela 1 - Vlerësimi i sinjifikancës së ndikimeve gjatë fazës së funksionimit të impiantit të ri të trajtimit të ujrave*

Lloji i ndikimit		Sinjifikanca e ndikimit (sa thelbësor është ndikimi)			
		I papërfillshëm	I ulët	I mesëm/I lartë	Ndikim pozitiv
1	Përgjatë fazës së funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave nuk do të kemi shkarkime të emetimeve në ajër.				
2.	Zhurmë e gjeneruar nga pjesët e impiantit (pompa, kapësi mekanik i hidrokarbureve etj.).				
3.	Emerim gazesh, aromash.				
4.	Ndikim i cili mund të ndikojë dhe prekë cilësinë e ujrave, është mos funksionimi i impiantit, dhe shkarkimi i tyre në mjedisin prritës.				
5.	Rrjedhje aksidentale të ujrave të patrajtuar me përmbajtje hidrokarbure të cilët mund të kontaminojnë tokën.				
6.	Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanikës.				
7.	Shqetësim dhe largim i mundshëm i llojeve të faunës si rezultat i zhurmave dhe gazeve.				
8.	Rrjedhje aksidentale dhe demtim kontaminim i florës/faunës.				

9.	Rrymat kryesore të gjenerimit të mbetjeve gjatë funksionimit të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura do të menaxhohen nga subjekti i licensuar.				
10.	Mjedisi socio -mjedisor	Ndërtimi dhe funksionimi i impiantit të ri të trajtimit të ujrave krahasuar me impiantin ekzistues do të shoqërohet vetëm me ndikime pozitive. Prandaj në të gjithë kollonën në të djathtë kryeson ngjyra e gjelbërt, për të shprehur se ndikimet në fazën e funksionimit krahasuar me impiantin ekzistues do të jenë më +.			
<p><i>Kurse persa i perkete sinjifikancës së ndikimeve gjatë fazës së funksionimit te rafinerise per perpunimin e naftes bruto dhe mbetjeve vajore ajo eshte e njejte me situaten aktuale. Pasi sic edhe e kemi shpjeguar edhe ne kapitujt e mesipermbetjeve vajore të gjeneruara nga industria portuale do të sillen ne cisterna në ambjentet e rafinerise dhe do te shkarkohen direkt në rezervuarin e grumbullimit të naftes bruto, e cila bashkë me të do ti nështrohet proceseve teknologjike nëpërmjet distilimit atmosferik, per përfitimin e nënprodukteve të naftës bruto dhe mbetjeve hidrokarbure (perfitimi i bitumit).</i></p>					

## 10. PROGRAMI I MONITORIMIT

### 10.1. Mekanizmi i Raportimit për Programin e Monitorimit Mjedisor

Një sistem i mirë raportimi do t'i sigurojë projektit mekanizmat e nevojshëm të reagimit për të siguruar cilësi dhe zbatim në kohë të punës. Sistemi i raportimit do të japë një mekanizëm për të siguruar që masat e propozuara në këtë projekt zbatimi por jo vetëm janë zbatuar. Ky mekanizëm raportimi do të zhvillohet në përputhje me kërkesat e ligjore shqiptare në përputhje dhe zbatim edhe të kushteve të lejes mjedisore.

Operatori nëpërmjet kontraktaktorit mjedisor do të zbatojë një plan të posaçëm monitorimi për mjedisin gjatë fazës së funksionimit të gjithë uzinës së përpunimit ku ushtron aktivitetin shoqëria, përfshirë këtu edhe impiantin e ri të trajtimit të ujrave i cili tashmë do të ndodhet në brendësi të zones së zhvillimit të aktivitetit.